

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI JURIDIK -DREJTIMI FINANCIARË

Kandidati: Saqip Murtezi

Mentori: Prof.Dr.Bedri Peci

Tema: **Politika Fiskale në Kosovë dhe harmonizimi me vendet e rajonit dhe BE-së**

ABSTRAKT

Ky material diskutimi analizon efektet e politikës fiskale në rritjen ekonomike të një vendi të vogël të hapur në zhvillim-Kosovës.

Me anë të këtij punimi kam paraqitur sfidat kryesore që politika fiskale ka në Kosovë dhe poashtu cilat janë alternativat procedurale ligjore për ti eliminuar defektet e politikës fiskale në Kosovë.

Kosova deri në shpalljen e pavarësisë më 2008 asnjëherë nuk ka aplikuar politika fiskale te pavarura. Për shkak të diskutimeve të shumta, se politikat fiskale në Kosovë kanë qenë jo stimuluese për bizneset Kosovare, prandaj ky punim ka për qëllim të përcaktojë sa kanë ndikuar politikat e aplikuara veçanërisht pas pavarësisë në rritjen ekonomike, zhvillimin e bizneseve dhe harmonizimin e legjislacionit me vendet e rajonit dhe BE-së.

Ndër sfidat kryesore që politika fiskale në Kosovë është duke u përballur janë harmonizimi i legjislacionit rreth politikave fiskale me BE-së.

Republika e Kosovës është shtet unitar dhe po ashtu të hyrat fiskale janë të koncentruara në buxhetin e shtetit, mirëpo nuk kemi shpërndarje të barabartë nëpër regjione apo komuna, të cilat kanë kontribuar në mbledhjen e tyre, duke bërë shpërndarje të buxhetit në komunat e preferuara dhe këtu nuk kemi vetëm shkelje ligjore, mirëpo edhe shkelje të parimit të demokracisë, sepse ai që paguan më shumë, duhet të kthehen në të hyra buxhetore.

Kosova nuk ka mundur të ndikojë në politikat monetare, të vetmin opsion e ka pasur politikat fiskale, të cilat nuk kanë pasur efekt në stimulimin e shoqërive vendore, veçanërisht prodhuese. Si rezultat, ajo nuk ka arritur të zvoglojë deficitin e madh tregtar, të krijoj kushte të volitshme për investime nga jashtë dhe të zvoglojë papunësinë dhe varfërinë.